



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2026

**“PËR**

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.162/2014 “PËR MBROJTJEN E  
CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS<sup>1</sup>”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

---

*Ky ligj është përafshuar me:*

- *Direktivën (BE) 2024/2881 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2024, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër për Evropën”, Numri CELEX 32024L2881, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L.*
- *Direktivën (BE) 2016/2284 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2016, “Për reduktimin e emetimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë (Direktiva NEC)”, Numri CELEX 32016L2284, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 344, datë 17.12.2016.*
- *Direktivën 1999/13/EC të Këshillit, datë 11 mars 1999, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) që rezultojnë nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime”, Numri CELEX 31999L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 85, datë 29.3.1999.*
- *Direktivën 2004/42/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për kufizimin e emetimeve të përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) për shkak të përdorimit të tretësve organikë në disa bojëra dhe llaqe dhe në produktet për rifiniturimin e automjeteve”, Numri CELEX 32004L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 143, datë 30.4.2004.*
- *Akte të tjera të Bashkimit Europian që lidhen me cilësinë e ajrit, emetimet në ajër dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.*

## Neni 1

Në nenin 3, shtohen përkufizimet, si më poshtë:

**“Aplikimi i modelimit”** është përdorimi i një sistemi modelimi, i kuptuar si një zinxhir modelesh dhe nën-modelesh, përfshirë të gjitha të dhënat hyrëse të nevojshme dhe çdo përpunim pasues;

**“Standardet e cilësisë së ajrit”:** janë vlerat limite, vlerat target, detyrimet për reduktimin e ekspozimit mesatar, objektivat e përqendrimit të ekspozimit mesatar, nivelet kritike, pragjet e alarmit, pragjet e informimit dhe objektivat afatgjata.

**“Depozitim total”** është masa totale e ndotësve që transferohen nga atmosfera në sipërfaqe, si toka, vegjetacioni, uji ose ndërtesat, në një zonë të caktuar brenda një periudhe të caktuar kohore;

**“Karbon i zi (BC)”** nënkupton aerosole karbonike të matura përmes absorbimit të dritës;

**“Grimca ultrafine (UFP)”** është grimca me diametër më të vogël ose të barabartë me 100 nm, ku UFP maten si përqendrime numerike të grimcave për centimetër kub, për një interval madhësie me kufi të poshtëm 10 nm dhe pa kufizim për kufirin e sipërm;

**“Potencial oksidues i lëndës së ngurtë pezull (PM10 dhe PM2.5)”** nënkupton një masë të kapacitetit të lëndës së ngurtë pezull për të oksiduar molekula objektivë potencialë;

**“Njësi territoriale e ekspozimit mesatar”** nënkupton një pjesë të territorit të Shqipërisë, të caktuar për qëllimet e përcaktimit të treguesit të ekspozimit mesatar, që korrespondon me një rajon NUTS 1 ose NUTS 2 sipas klasifikimit të njësive territoriale për statistika (NUTS) të Bashkimit Evropian, ose një kombinim i dy ose më shumë rajoneve ngjitur NUTS 1 ose NUTS 2, me kusht që sipërfaqja e tyre e përbashkët të jetë më e vogël se territori i plotë i atij shteti anëtar dhe jo më e madhe se 85 000 km<sup>2</sup>;

**“Prag vlerësimi”** nënkupton nivelin që përcakton regjimin e vlerësimit që duhet të përdoret për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis ;

**“Vlerësim objektiv”** është informacioni mbi nivelin e përqendrimit ose depozitimit të një ndotësi të caktuar, të marrë përmes analizës së ekspertëve dhe që mund të përfshijë përdorimin e mjeteve statistikore;

**“Përfaqësueshmëri hapësinore”** nënkupton një qasje vlerësimi sipas së cilës treguesit e cilësisë së ajrit të vëzhguar në një pikë matjeje janë përfaqësues për një zonë gjeografike të përcaktuar në mënyrë eksplicite, në masën që treguesit e cilësisë së ajrit brenda asaj zone nuk ndryshojnë nga treguesit e vëzhguar në pikën e matjes më shumë se një nivel tolerance i paracaktuar;

**“Pika të nxehta të ndotjes së ajrit”** janë vende brenda një zone ku regjistrohen përqendrimet më të larta të ndotësve të ajrit, ndaj të cilave popullsia ka gjasa të ekspozohet drejtpërdrejt ose tërthorazi për një periudhë të konsiderueshme në raport me periudhën e mesatares së vlerave kufi ose vlerave të synuara, përfshirë rastet kur niveli i ndotjes ndikohet nga emetimet e burimeve të ndotjes së rëndë, si rrugët e ngarkuara dhe me trafik të dendur, një burim i vetëm industrial ose një zonë industriale me shumë burime, porte, aeroporte, ngrohje intensive rezidenciale, ose një kombinim i këtyre burimeve;

**Vende me sfond urban”** nënkupton vende në zona urbane ku nivelet janë përfaqësuese të ekspozimit të popullsisë së përgjithshme.

**“Vende me sfond rurale”** nënkupton vende në zona rurale me dendësi të ulët populsië ku nivelet janë përfaqësuese të ekspozimit të popullsisë së përgjithshme rurale, vegjetacionit dhe ekosistemeve natyrore;

**“Super-stacion monitorimi”** është një stacion monitorimi në një vend me sfond urban ose me sfond rural, që kombinon disa pika matjeje për të mbledhur të dhëna afatgjata për disa ndotës;

**“Detyrim për reduktimin e ekspozimit mesatar”** nënkupton një reduktim në përqindje të ekspozimit mesatar të popullsisë, të shprehur përmes treguesit të ekspozimit mesatar, për një njësi territoriale të ekspozimit mesatar, i vendosur me qëllim reduktimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut, që duhet të arrihet brenda një periudhe të caktuar dhe të mos tejkalohet pasi të jetë arritur;

**“Udhërrëfyesi i cilësisë së ajrit”** nënkupton një plan të cilësisë së ajrit, të miratuar përpara afatit të përmbushjes së vlerave kufi dhe vlerave të synuara, që përcakton politikat dhe masat për të përmbushur këto vlera brenda afatit të përmbushjes;

**“Plani i cilësisë së ajrit”** është një plan që përcakton politikat dhe masat për të siguruar përputhjen me vlerat kufi, vlerat e synuara ose detyrimet për reduktimin e ekspozimit mesatar.

**“Plan veprimi afatshkurtër”** nënkupton një plan që përcakton masa emergjente që duhet të ndërmerren në afat të shkurtër për të reduktuar rrezikun e menjëhershëm ose kohëzgjatjen e tejkalimit të pragjeve të alarmit;

**“Popullatë e ndjeshme dhe grup vulnerabël”** nënkupton ato grupe të popullsisë që janë në mënyrë të përhershme ose të përkohshme më të ndjeshme ose më vulnerabël ndaj efekteve të ndotjes së ajrit sesa popullsia mesatare, për shkak të karakteristikave specifike që e bëjnë ekspozimin më të dëmshëm për shëndetin, ose për shkak të një ndjeshmërie më të lartë, një pragu më të ulët për efektet shëndetësore ose një aftësie të reduktuar për t’u vetëmbrojtur;

**“Publik i interesuar”** nënkupton një ose më shumë persona fizikë ose juridikë që preken ose ka gjasa të preken, ose që kanë interes në procedurat

vendimmarrëse për qëllimet të këtij ligji, si dhe organizatat joqeveritare që promovojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit dhe që përmbushin çdo kërkesë sipas legjislacionit kombëtar konsiderohen se kanë interes.

**“Objektiv për përqendrimin e ekspozimit mesatar”** nënkupton një nivel të treguesit të ekspozimit mesatar që duhet të arrihet, me qëllim reduktimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut;

Pika 13 e nenit 13 ndryshon si më poshtë:

**“Aglomerat”** nënkupton një bashkim urban me popullsi mbi 250 000 banorë ose, kur popullsia është 250 000 banorë ose më pak, një zonë me dendësi popullore më të madhe se 3000 banorë/km<sup>2</sup>.

Pika 16 e nenit 13 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

**“Publik”** është një ose më shumë persona, personi fizikë ose juridik dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, organizatat jofitimprurëse dhe grupimet e tyre”.

## Neni 2

Në nenin 5 kryhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Vlerësimi i cilësisë së ajrit të mjedisit kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet nënligjore përkatëse sipas ndarjes së territorit në zona dhe aglomerate.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton vendimin që parashikon rregullat për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në lidhje me ndotësit e përcaktuar në Aneksin I, duke përcaktuar vlerat kufi, vlerat e synuara, pragjet e alarmit dhe të informimit, metodologjitë dhe kriteret e vlerësimit, përfshirë metodat e matjes dhe kërkesat për cilësinë e të dhënave, kërkesat për pakësimin e ekspozimit ndaj PM<sub>2,5</sub>, organizimin dhe funksionimin e rrjetit të monitorimit, si dhe klasifikimin e zonave dhe aglomerateve.
3. Në territorin e Republikës së Shqipërisë vendoset të paktën një superstacion monitorimi në një vendndodhje me sfond urban dhe të paktën një superstacion monitorimi në një vendndodhje me sfond rural, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Rregullat për krijimin, vendosjen, administrimin, funksionimin dhe kërkesat teknike për këto superstacione miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

### Neni 3

Neni 7 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

#### **Strategjia Kombëtare, Planet e cilësisë së ajrit dhe Udhërrëfyesi për cilësinë e ajrit**

1. Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit përcakton objektivat, politikat dhe masat afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit, për reduktimin e ndotjes së ajrit dhe për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit. Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, energjinë, transportin dhe sektorë të tjerë përkatës. Strategjia rishikohet në mënyrë periodike të paktën çdo dhjetë vjet.
2. Plani i cilësisë së ajrit përgatitet dhe zbatohet për një zonë ose aglomerat kur nivelet e ndotësve në ajrin e mjedisit tejkalojnë vlerat kufi, vlerat e synuara të përcaktuara sipas vendimit të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.
3. Planet e cilësisë së ajrit përcaktojnë masat e nevojshme për arritjen e përputhshmërisë me vlerat e synuara dhe për mbajtjen sa më të shkurtër të mundshme të periudhës së tejkalimit të vlerave kufi dhe vlerës së synuar, në cdo rast jo më gjatë se 4 vjet nga fundi i vitit kalendarik në të cilën është regjistruar tejkalimi i parë.
4. Planet e cilësisë së ajrit hartohen sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se dy vjet pas vitit kalendarik gjatë të cilit është konstatuar tejkalimi i vlerave të synuara të përcaktuara sipas vendimit të këshillit të ministrave të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.
5. Kur, në një zonë , nivelet e ozonit në ajrin e mjedisit tejkalojnë vlerën e synuar , hartohet një plan i cilësisë së ajrit ose një udhërrëfyes për cilësinë e ajrit për atë zonë, me qëllim arritjen e kësaj vlere dhe kufizimin sa më të shkurtër të mundshëm të periudhës së tejkalimit. Përgjatë, një plan i tillë mund të mos hartohet kur, duke marrë parasysh kushtet gjeografike dhe meteorologjike, nuk ka mundësi të konsiderueshme për uljen e përqendrimeve të ozonit.
6. Kur, në një zonë ose aglomerat, ekziston rreziku që nivelet e ndotësve në ajrin e mjedisit tejkalojnë një ose më shumë nga pragjet e alarmit të përcaktuara sipas këtij ligji, njësitë e qeverisjes vendore përgatisin dhe zbatojnë plane veprimi afatshkurtra për të reduktuar rrezikun e tejkalimit dhe për të kufizuar kohëzgjatjen dhe intensitetin e episodeve të ndotjes së ajrit.

7. Kur në zonë të ekspozimit mesatar nuk përmbushet detyrimi për reduktimin e ekspozimit mesatar, hartohet një plan i cilësisë së ajrit që përcakton masat e nevojshme për përmbushjen e këtij detyrimi dhe për kufizimin e periudhës së tejkallimit jo më vonë se dy vjet pas përfundimit të vitit kalendarik gjatë të cilit është reduktuar tejkallimi i detyrimit për reduktimin e ekspozimit mesatar.
8. Planet e cilësisë së ajrit dhe udhërrëfyesi për cilësinë e ajrit përmbajnë të paktën informacionin e përcaktuar në Aneksin II të këtij ligji dhe mund të përfshijnë masa të posaçme për mbrojtjen e popullsisë së ndjeshme dhe grupeve vulnerabël, në veçanti fëmijët, të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike.
9. Planet e cilësisë së ajrit dhe udhërrëfyesit për cilësinë e ajrit rishikohen kur tejkallimet e vlerave kufi, detyrimeve për reduktimin e ekspozimit mesatar ose vlerave të synuara vazhdojnë edhe pas afatit të përcaktuar për hartimin e tyre. Në çdo rast, përditësimi kryhet jo më vonë se pesë vjet nga afati i hartimit të planit apo udhërrëfyesit të mëparshëm.”
10. Planet e cilësisë së ajrit dhe udhërrëfyesit e cilësisë së ajrit përgatiten në përputhje dhe në koordinim me strategjitë, planet dhe dokumentet e tjera përkatëse në fushën e mjedisit, energjisë, transportit, bujqësisë dhe shëndetit publik.
11. Përgatitja e planeve të cilësisë së ajrit dhe udhërrëfyesit për cilësinë e ajrit kryhet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për mjedisin, shëndetin publik dhe sektorët përkatës, njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe me grupet e interesit.
12. Para miratimit të tyre, strategjia kombëtare, planet e cilësisë së ajrit, udhërrëfyesi për cilësinë e ajrit dhe planet e veprimit afatshkurtër i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Informimi dhe pjesëmarrja e publikut dhe e palëve të interesuara sigurohet në përputhje me me kërkesat për informimin e publikut të përcaktuara në Aneksin 3 të këtij ligji.”

#### **Neni 4**

Në pikën 1 të nenit 10 shtohen gërmat « f » dhe « g » me përmbajtje, si më poshtë:

“ f. informacion mbi indeksin e cilësisë së ajrit, i cili pasqyron gjendjen e përgjithshme të cilësisë së ajrit dhe përditësohet të paktën çdo orë për të paktën për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit, grimcat e pezulluara (PM10 dhe PM2,5) dhe ozonin. Indeksi mund të përfshijë edhe ndotës të tjerë, kur është e përshtatshme.

g. për simptomat që lidhen me kulmet e ndotjes së ajrit dhe mbi sjelljet për reduktimin e ekspozimit ndaj ndotjes dhe mbrojtjen shëndetësore, dhe inkurajojnë shfaqjen e këtij informacioni në vende të frekuentuara nga popullsia e ndjeshme dhe grupet vulnerabël.”

## **Neni 5**

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me përmbajtje si më poshtë vijon:

### **Neni 10/1**

Sistemi i informacionit për cilësinë e ajrit

1. Të dhënat për cilësinë e ajrit të mjedisit administrohen si pjesë e Sistemit të Integruar Mjedisor (SIM).
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave për cilësinë e ajrit, si dhe për integrimin e tyre në SIM.
3. Institucionet publike, njësitë e qeverisjes vendore, operatorët dhe subjektet e autorizuar sigurojnë raportimin e të dhënave që lidhen me cilësinë e ajrit pranë AKM-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e përcaktuara për SIM.
4. Administrimi, shkëmbimi dhe publikimi i të dhënave për cilësinë e ajrit realizohen në përputhje me legjislacionin për qeverisjen elektronike dhe aktet nënligjore në fuqi për Sistemin e Integruar Mjedisor.

## **Neni 6**

Në nenin 18 pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Ministria identifikon, për vitin përkatës:

- a) zonat në të cilat transferimi ndërkufitar i ndotjes së ajrit nga një ose më shumë shtete fqinje kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në tejkalimin e vlerave kufi ose vlerave objektiv në ato zona;
- b) njësitë territoriale të ekspozimit mesatar, në të cilat transferimi ndërkufitar i ndotjes së ajrit nga një ose më shumë shtete fqinje kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në tejkalimin e nivelit të përcaktuar nga detyrimet për uljen e ekspozimit mesatar në ato njësi.
- c) kur është e përshtatshme, autoritetet kompetente bashkëpunojnë me shtetet fqinje për krijimin dhe funksionimin e stacioneve të përbashkëta të monitorimit ose të superstacioneve të monitorimit për vlerësimin e ndotjes ndërkufitare të ajrit dhe për shkëmbimin e të dhënave përkatëse të monitorimit

## **Neni 7**

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me përmbajtje si vijon :

### **“Neni 19/1**

#### **Kompensimi për dëmet ndaj shëndetit të njeriut**

1. Çdo person që ka pësuar dëmtim të shëndetit si pasojë e një shkeljeje serioze të detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga autoritetet kompetente, të kryer me dashje ose nga pakujdesia, mund të kërkojë kompensim për dëmin e pësuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kusht që të provohet ekzistenca e një lidhjeje të drejtpërdrejtë shkakësore midis shkeljes dhe dëmit.
2. Rregullat dhe procedurat që rregullojnë paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kompensim sipas këtij neni përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të tillë që të mos e bëjnë të pamundur ose tepër të vështirë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.
3. E drejta për të kërkuar kompensim sipas këtij neni parashkruhet brenda 3 vjetëve nga data kur personi i dëmtuar ka marrë dijeni, ose mund të pritej në mënyrë të arsyeshme të merrte dijeni, për dëmin dhe për lidhjen e tij me shkeljen.
4. Afati i parashkrimit nuk fillon të rrjedhë përpara se shkelja të ketë pushuar dhe përpara se personi që kërkon kompensimin të dijë, ose të mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të dijë, se ka pësuar dëm si pasojë e kësaj shkeljeje.
5. Në çdo rast, e drejta për të kërkuar kompensim nuk mund të ushtrohet pas kalimit të 10 vjetëve nga momenti i kryerjes së shkeljes.

## **Neni 8**

Në nenin 21 kryhen ndryshimet, si vijon:

1. Publiku i interesuar mund t'i drejtohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me kërkesë për rishikim administrativ për të kundërshtuar ligjshmërinë materiale ose procedurale të vendimeve, akteve ose mosveprimeve që lidhen me:
  - a) vendndodhjen dhe numrin e pikave të marrjes së mostrave, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave sipas nenit 5 të këtij ligji;
  - b) planet e cilësisë së ajrit dhe udhërrëfyesit e cilësisë së ajrit;në rastet kur:

- i) publiku i interesuar ka një interes të ligjshëm; ose  
ii) pretendon cenimin e një të drejte.
2. Çdo organizatë jofitimprurëse që promovon mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose të mjedisit konsiderohet të ketë interes të ligjshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni.
  3. Kërkesa për rishikim sipas paragrafit 1 shoqërohet me informacionin dhe dokumentacionin përkatës që mbështet pretendimin.
  4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur dhe merr vendim për pranimin ose refuzimin e saj.
  5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit informon publikun për vendimin e marrë, duke dhënë arsyet përkatëse, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
  6. Procedura e rishikimit sipas këtij neni zbatohet pa cenuar të drejtën për rishikim gjyqësor në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  7. Procedurat e rishikimit sipas këtij neni dhe procedurat gjyqësore të lidhura me to zhvillohen në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të shpejtë dhe nuk duhet të jenë tepër të kushtueshme për palët.

## **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 9**

#### **Aktet Nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij. Deri në miratimin e këtyre akteve, Aktet nënligjore të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe për aq sa nuk bien ndesh me të, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji.
2. Ministri përgjegjës për mjedisin, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr ose përditëson urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera të nevojshme për zbatimin e tij.

### **Neni 10**

#### **Shfuqizimi i akteve nënligjore**

1. Me hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të miratuara sipas nenit 8, pika 1, të këtij ligji, shfuqizohen aktet nënligjore si më poshtë:
  - a) VKM nr. 803/2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”.
  - b) VKM 352/2015.

2. Çdo referencë në legjislacionin në fuqi ndaj akteve të shfuqizuara sipas pikës 1 të këtij neni konsiderohet si referencë ndaj këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Shfuqizimi i akteve nënligjore sipas këtij neni nuk cenon vlefshmërinë e akteve administrative të nxjerra para hyrjes në fuqi të akteve të reja, të cilat vijojnë të prodhojnë efekte juridike deri në përfundimin e afatit të tyre ose zëvendësimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 11**

#### **Dispozita kalimtare**

1. Planet e cilësisë së ajrit, dhe planet afatshkurtra të veprimit, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten në fuqi dhe vijojnë të prodhojnë efekte juridike deri në përfundimin ose rishikimin e tyre, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj. Autoritetet kompetente i rishikojnë dhe, kur është e nevojshme, i përshtatin këto akte me kërkesat e këtij ligji.
2. Lejet mjedisore, autorizimet e integruara mjedisore dhe çdo akt tjetër administrativ i dhënë sipas legjislacionit në fuqi përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji mbeten të vlefshme për afatin për të cilin janë dhënë. Në rast rinovimi, ndryshimi ose rishikimi, ato përshtaten me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Strategjia Kombëtare për Cilësinë e Ajrit, e miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbetet në fuqi deri në miratimin e një strategjie të re sipas këtij ligji dhe rishikohet brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e tij.
4. Procedurat administrative të filluara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji përfundojnë sipas legjislacionit në fuqi në momentin e fillimit të tyre, përveç rasteve kur subjekti kërkon zbatimin e këtij ligji.

### **Neni 12**

#### **Hyrja në fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
2. Dispozitat që parashikojnë miratimin e vlerave të reja kufi dhe vlerave të synuara zbatohen nga data e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore përkatëse.
3. Dispozitat për kompensimin e dëmit në shëndet zbatohen vetëm për shkeljet e ndodhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## **ANEKSI I**

### **Lista e ndotësve të ajrit**

Ky ligj zbatohet të paktën për ndotësit e mëposhtëm të ajrit të mjedisit.

#### **Grupi I – Ndotësit kryesorë për të cilët përcaktohen vlera kufi**

1. Dyoksidi i squfurit (SO<sub>2</sub>)
2. Dyoksidi i azotit (NO<sub>2</sub>)
3. Oksidet e azotit (NO<sub>x</sub>)
4. Lënda e ngurtë pezull (PM<sub>10</sub>)
5. Lënda e ngurtë pezull (PM<sub>2,5</sub>)
6. Plumbi (Pb)

#### **Grupi II – Ndotës për të cilët përcaktohen vlera të synuara ose objektiva afatgjatë**

7. Ozoni (O<sub>3</sub>)

#### **Grupi III – Ndotës të tjerë të rëndësishëm për cilësinë e ajrit dhe shëndetin e njeriut**

8. Benzeni (C<sub>6</sub>H<sub>6</sub>)
9. Monoksidi i karbonit (CO)
10. Hidrokarburet aromatike policiklike (PAH), të shprehura si benzo(a)pireni (BaP)

#### **Grupi IV – Metale të rënda në ajrin e mjedisit**

11. Arseniku (As)
12. Kadmiumi (Cd)
13. Nikeli (Ni)
14. Mërkuri (Hg)

#### **Grupi V – Ndotës shtesë për monitorim dhe vlerësim**

15. Amoniaku (NH<sub>3</sub>)
16. Përbërjet organike të paqëndrueshme jo-metanike (NMVOC)

Lista e ndotësve të ajrit mund të përditësohet ose plotësohet me akte nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji, në përputhje me zhvillimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian.”

## **ANEKSI II**

**Informacioni që duhet të përfshihet në planet e cilësisë së ajrit dhe në udhërrëfyesit e cilësisë së ajrit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit**

### **Seksioni A**

**Informacioni që duhet të përfshihet në planet e cilësisë së ajrit dhe në udhërrëfyesit e cilësisë së ajrit**

#### **1. Lokalizimi i ndotjes së tepërt**

- a) \_\_\_\_\_ rajoni;
- b) \_\_\_\_\_ qyteti \_\_\_\_\_ ose \_\_\_\_\_ qytetet \_\_\_\_\_ përkatëse \_\_\_\_\_ (hartë);
- c) pikat e marrjes së mostrave ose stacionet e monitorimit (hartë dhe koordinata gjeografike).

#### **2. Informacion i përgjithshëm**

- a) lloji i zonës (zonë urbane, industriale ose rurale) ose karakteristikat e njësisë territoriale të ekspozimit mesatar;
- b) vlerësimi i sipërfaqes së ndotur (km<sup>2</sup>) dhe i popullsisë së ekspozuar ndaj ndotjes;
- c) përqendrimet e vëzhguara të ndotësve ose treguesi i ekspozimit mesatar për ndotësin përkatës, për të paktën pesë vite para tejkalimit deri në të dhënat më të fundit, duke përfshirë krahasimin me vlerat kufi, vlerat e synuara ose detyrimet për uljen e ekspozimit mesatar;
- ç) të dhëna klimatike të nevojshme;
- d) të dhëna përkatëse mbi topografinë;
- dh) informacion mbi objektivat që kërkojnë mbrojtje në zonë, përfshirë shëndetin e njeriut, vegjetacionin dhe ekosistemet.

#### **3. Autoritetet përgjegjëse**

Emërtesat dhe adresat e autoriteteve kompetente përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të cilësisë së ajrit ose udhërrëfyesve të cilësisë së ajrit.

#### **4. Origjina e ndotjes**

- a) lista e burimeve kryesore të emetimeve përgjegjëse për ndotjen;
- b) sasia totale e emetimeve nga këto burime (ton/vit);
- c) vlerësimi i nivelit të emetimeve (nivel qyteti, rajonal, kombëtar dhe kontribute ndërkufitare);
- ç) ndarja sipas burimeve (source apportionment) sipas sektorëve përkatës që kontribuojnë në tejkalimin e standardeve të cilësisë së ajrit.

#### **5. Përshkrimi i skenarit bazë**

Përshkrimi i skenarit bazë të përdorur për hartimin e planit ose udhërrëfyesit të cilësisë së ajrit, duke përfshirë zhvillimin e projektuar të emetimeve dhe përqendrimeve të ndotësve në rast të mosmarrjes së masave.

#### **6. Identifikimi i masave të mundshme për reduktimin e ndotjes së ajrit**

- a) lista dhe përshkrimi i masave të konsideruara për përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- b) identifikimi i autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e secilës masë;
- c) vlerësimi i uljes së emetimeve (ton/vit) dhe, kur është e mundur, ulja e përqendrimeve për secilën masë.

#### **7. Masat e përzgjedhura dhe ndikimi i tyre i pritshëm**

- a) lista e masave të përzgjedhura për arritjen e standardeve të cilësisë së ajrit;
- b) afati kohor për zbatimin e secilës masë dhe autoritetet përgjegjëse;
- c) ulja e pritshme e emetimeve nga zbatimi i masave;
- ç) ulja e pritshme e përqendrimeve të ndotësve në pikat e marrjes së mostrave ku tejkalohe vlerat kufi ose vlerat e synuara;
- d) trajektorja orientuese drejt përputhshmërisë dhe viti i parashikuar i arritjes së saj;
- dh) shpjegimi i mënyrës se si masat e planifikuara do të sigurojnë që periodha e tejkalimit të jetë sa më e shkurtër.

#### **8. Informacion shtesë**

- a) të dhëna klimatike;
- b) të dhëna mbi topografinë;
- c) informacion mbi objektivat që kërkojnë mbrojtje;
- ç) lista dhe përshkrimi i masave shtesë me ndikim afatgjatë;
- d) informacion socio-ekonomik mbi zonën përkatëse;
- dh) përshkrimi i metodologjisë dhe supozimeve të përdorura për projeksionet e cilësisë së ajrit;
- e) dokumentet dhe informacioni i përdorur për vlerësimin.

#### **9. Informimi dhe konsultimi publik**

Përmbledhje e masave të informimit dhe konsultimit publik të ndërmarra gjatë hartimit të planit ose udhërrëfyesit të cilësisë së ajrit, rezultatet e tyre dhe mënyra se si këto rezultate janë marrë parasysh në dokumentin përfundimtar.

#### **10. Vlerësimi i masave (në rast përditësimi të planit)**

- a) vlerësimi i zbatimit të masave nga plani i mëparshëm i cilësisë së ajrit;
- b) vlerësimi i ndikimit të këtyre masave në uljen e emetimeve dhe përqendrimeve të ndotësve.

## **Listë orientuese e masave për reduktimin e ndotjes së ajrit**

Planet e cilësisë së ajrit dhe udhërrëfyesit mund të përfshijnë masa të tilla si:

- a) uljen e emetimeve nga burimet stacionare dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave;
- b) reduktimin e emetimeve nga transporti rrugor përmes modernizimit të flotës së mjeteve dhe përdorimit të mjeteve me emetime të ulëta ose zero;
- c) promovimin e transportit publik dhe formave të qëndrueshme të mobilitetit;
- ç) masa të planifikimit urban dhe menaxhimit të trafikut për reduktimin e emetimeve;
- d) zhvillimin e infrastrukturës për karburante alternative;
- dh) masa për reduktimin e ndotjes nga burimet industriale dhe energjetike;
- e) masa për reduktimin e ndotjes nga transporti detar dhe ajror;
- f) masa për reduktimin e emetimeve nga bujqësia;
- g) masa për mbrojtjen e popullsisë së ndjeshme dhe grupeve vulnerabël;
- gj) masa për të nxitur ndryshime në sjelljen e konsumatorëve dhe përdorimin e energjisë.

## **Seksioni B**

### **Masat emergjente që duhet të konsiderohen në planet afatshkurtra të veprimit**

Masat emergjente që mund të konsiderohen për përfshirje në planet afatshkurtra të veprimit përfshijnë:

- a) kufizimin e qarkullimit të mjeteve, veçanërisht pranë zonave të frekuentuara nga popullsia e ndjeshme;
- b) ofrimin e transportit publik me tarifë të ulët ose pa tarifë;
- c) pezullimin e përkohshëm të aktiviteteve të ndërtimit;
- ç) pastrimin e rrugëve;
- d) organizime fleksibile të punës për të reduktuar trafikun dhe ekspozimin ndaj ndotjes.

## **ANEKSI III**

### **Informimi i publikut mbi cilësinë e ajrit të mjedisit**

#### **1. Informacioni mbi cilësinë e ajrit**

Ministria siguron që publiku të informohet rregullisht dhe në mënyrë të përditësuar mbi cilësinë e ajrit të mjedisit. Për këtë qëllim bëhen të disponueshme të paktën informacionet e mëposhtme:

- a) të dhëna të përditësuara, dhe kur është e mundur edhe në baza orare, për përqendrimit e ndotësve në ajrin e mjedisit, të marra nga pikat e marrjes së mostrave

për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit, lëndën e ngurtë pezull (PM10 dhe PM2,5), monoksidin e karbonit dhe ozonin;

b) përqendrimet e matura të ndotësve në ajrin e mjedisit, të paraqitura sipas periudhave përkatëse të mesatarizimit, si dhe, kur është e mundur, krahasimi i tyre me vlerat udhëzuese më të fundit të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH);

c) informacion mbi tejkalimet e vëzhguara të vlerave kufi, vlerave të synuara dhe detyrimeve për reduktimin e ekspozimit mesatar, duke përfshirë të paktën:

- vendndodhjen ose zonën e tejkalimit;
- kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen e tejkalimit;
- përqendrimin e matur në krahasim me standardet përkatëse të cilësisë së ajrit;

ç) informacion mbi ndikimet e ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut, duke përfshirë:

- ndikimet mbi popullsinë e përgjithshme;
- ndikimet mbi popullsinë e ndjeshme dhe grupet vulnerabël;
- përshkrimin e simptomave të mundshme;
- masat parandaluese të rekomanduara për popullsinë;
- burimet ku mund të gjendet informacion shtesë;

d) informacion mbi ndikimet e ndotjes së ajrit në vegjetacion dhe në ekosisteme;

dh) informacion mbi masat parandaluese për reduktimin e ndotjes dhe të ekspozimit ndaj saj, duke përfshirë:

- identifikimin e sektorëve kryesorë të burimeve të ndotjes;
- rekomandime për masa për reduktimin e emetimeve;

e) informacion mbi fushatat e matjes, aktivitetet e monitorimit dhe rezultatet e tyre, kur këto janë kryer;

f) informacion mbi indeksin e cilësisë së ajrit, i cili pasqyron gjendjen e përgjithshme të cilësisë së ajrit dhe përditësohet të paktën çdo orë për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit, lëndën e ngurtë pezull (PM10 dhe PM2,5) dhe ozonin. Ky indeks mund të përfshijë edhe ndotës të tjerë, kur është e përshtatshme.

## **2. Informimi për tejkalimet e pragjeve të alarmit dhe të informimit**

Ministria siguron që publiku të informohet në kohë për çdo tejkalim aktual ose të parashikuar të pragjeve të alarmit ose të informimit.

Informacioni i dhënë përfshin të paktën:

a) informacion mbi tejkalimet e vëzhguara, duke përfshirë:

- vendndodhjen ose zonën e tejkalimit;
- llojin e pragut të tejkaluar (prag alarmi ose prag informimi);
- kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen e tejkalimit;
- përqendrimin maksimal njëorësh dhe, në rastin e ozonit, përqendrimin maksimal mesatar tetëorësh;

b) parashikimin për periudhën në vijim, duke përfshirë:

- zonën gjeografike ku pritet tejkalmi;
- ndryshimet e pritshme të niveleve të ndotjes (përmirësim, stabilizim ose përkeqësim) dhe arsyet përkatëse;

c) informacion mbi popullsinë e prekur dhe efektet e mundshme në shëndet, duke përfshirë:

- grupet e popullsisë në rrezik;
- përshkrimin e simptomave të mundshme;
- masat parandaluese të rekomanduara për popullsinë;
- burimet ku mund të gjendet informacion shtesë;

ç) informacion mbi planet afatshkurtra të veprimit dhe masat parandaluese për reduktimin e ndotjes dhe ekspozimit ndaj saj, duke përfshirë sektorët kryesorë të burimeve të ndotjes dhe rekomandime për reduktimin e emetimeve;

d) rekomandime për masa për reduktimin e ekspozimit të popullsisë.

Në rast të tejkalimeve të parashikuara, ministria merr masat e nevojshme për të siguruar që ky informacion të shpërndalet sa më gjerësisht dhe në kohë.

### **3. Informimi shtesë në rast tejkalmi**

Kur ndodh një tejkalm ose ekziston rreziku i tejkalimit të një vlere kufi, vlere të synuar, detyrimi për reduktimin e ekspozimit mesatar, prag alarmi ose prag informimi, ministria siguron që informacioni i përcaktuar në këtë aneks të bëhet gjerësisht i disponueshëm dhe të promovohet në mënyrë aktive për publikun.

### **4. Formatet dhe kanalet e publikimit të informacionit**

Informacioni i përmendur në këtë aneks bëhet i disponueshëm për publikun në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme përmes mjeteve të përshtatshme të komunikimit, duke përfshirë:

- faqet zyrtare të internetit të institucioneve përgjegjëse;
- platformat dhe portalet dixhitale të informacionit publik;
- aplikacionet mobile dhe shërbime të tjera elektronike;
- median dhe kanale të tjera të komunikimit publik.